



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1043/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Faton Bajrami, anëtar në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NTSH “Pëllumbi Commerce” me seli në Podujevë, Rr. Hyzri Talla, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.869/19, të datës 08.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 04.09.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës, Administrata Tatimore e Kosovës, e dt.18.05.2021, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr.869/19, i datës 08.03.2021, **Vërtetohet.**

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.869/19, të datës 08.03.2021, në dispozitivin e I është aprovuar pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit NTSH “Pëllumbi Commerce” me seli në Podujevë, Rr. “Hyzri Talla”, është anuluar pjesërisht vendimi nr.30/2019 i datës 12.03.2019 i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë. Obligohet e paditura Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë që paditësit NTSH “Pëllumbi Commerce” me seli në Podujevë, Rr. Hyzri Talla t’ia kthej mjetet financiare të paguara në emër të detyrimeve tatimore për periudhën e kontrollit 2014-2017 si

rezultat i mos njohjes me kontroll për qëllime tatimore të zbritshme të shpenzimeve të transportit të përfshira në Deklarata Unike Doganore, dhe atë për periudhat dhe llojet e tatimeve në shumat e specifikuar si në vijim: **a)** Në emër të Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar (TVSH-së) për periudhën 2014-2016 t'ia kthej shumën e paguar prej 8,302.60€, ndërsa në emër të ndëshkimeve të aplikuar për këtë shumë, t'ia kthej shumën e paguar prej 2,075.65€. **b)** Në emër të Tatimit në të Ardhura Personale (TAP-PD) për periudhën 2016-2017, t'ia kthej shumën e paguar prej 11,037.79€, ndërsa në emër të ndëshkimeve të aplikuar për këtë shumë t'ia kthej shumën e paguar prej 2,759.44€. **c)** Në emër të Kontributeve Pensionale Individuale për periudhën 2016-2017 t'ia kthej shumën e paguar prej 2,522.70€, ndërsa në emër të ndëshkimeve të aplikuar për këtë shumë, t'ia kthej shumën e paguar prej 630.67€. **d)** Në emër të Ndëshkimeve Administrative për mos krijim dhe mos mbajtje të regjistrimeve, t'ia kthej shumën e paguar prej 3000.00€, të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 30,328.85€. Refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit për kthimin e shumës prej 1000.00€ të paguar në emër të Ndëshkimit Administrativ për moskrijim dhe mos mbajtje të regjistrimeve, për periudhën 09/2014. Mbetet në fuqi pjesa tjetër e vendimit nr.30/2019 i datës 12.03.2019 i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale në konflikt administrativ.

Kundër këtij vendimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar e paditura ATK, me të cilën e kundërshton ligjshmërinë e aktgjykimit për shkak të; shkeljes së dispozitave të procedurës administrative, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, propozon që të aprovohet ankesa e të paditurës ATK, si e bazuar dhe aktgjykimi ankimuar i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe të mbetet në fuqi vendimi kontestues i ATK-së çështja të kthehet në Gjykatën e Shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale- Dhoma e Shkallës së dytë shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, e paditura me vendimin, nr. 30/2019 i datës 12.03.2019, ka refuzuar si të pa bazë ankesën Nr.30/2019 e datës 16.01.2019 NTSH “Pëllumbi Commerce” me numër rendor të biznesit NRB:80310714 dhe me numër fiskal NRF: 600112594 me pronar Z. F.M. me seli të biznesit në adresën Rr. Hyzri Talla p.n. Podujevë, në mbështetje të nenit 132/2 të Ligjit Nr. 05/L-031 Për Procedurën Administrative në lidhje me nenit 89, paragrafi 2, të Ligjit nr. 03/L-222 “Për Administratën Tatimore dhe Procedurat”. Në pikën II Njoftim Rivlerësimet e Tatimit Shtesë dhe ndëshkimet të caktuara me kontroll, konfirmohen si të bazuara. Në pikën III. Procedura e ankesës nuk ndërprejnë sanksionet për mos përmbushje dhe interesin për ndonjë lloj tatimi, sipas Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

I pakënaqur me vendimin e ATK-së, paditësi, ushtron padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në procedurë të konfliktit administrativ. Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor, në prani të autorizuarit të palës paditëse dhe në mungesë të përfaqësuesit të paditurës, dhe vërtetimit të gjendjes faktike gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar me arsyetim se e paditura nuk ka vepruar drejtë kur me raportin e kontrollit të datës 21.12.2018 dhe të konfirmuar me vendimin e kontestuar fillimisht për vitin 2014 për vitin 2015 dhe për vitin 2016 deri në periudhën 05/2016, paditësit i ka njohur vetëm shpenzimet e transportit të inkorporuar në Deklaratat Unike Doganore me të cilat është zhdoganuar malli i importuar nga paditësi duke mos i pranuar shpenzimet e blerjes së karburantit në tregun e brendshëm për këtë periudhë, ndërsa pas kësaj periudhe duke u thirrur në Vendimin Shpjegues Publik nr.3/2016 për Vlerësimet dhe Rivlerësimet Doganore, paditësit i ka njohur shpenzimet e karburantit bazuar në faturat e blerjeve, duke eliminuar shpenzimet e transportit të kalkuluar në DUD-a. E paditura duke vepruar në këtë mënyrë mbi bazën e legjislacionit të njëjtë i cili ka qenë në fuqi sa i përket çështjes së njohjes së shpenzimeve dhe kreditimeve të lejuara ka përdorë standarde të dyfishta. Në periudhën e kontrollit 01/2014-05/2016 e paditura pa dhënë arsyetim të bazuar ligjor dhe faktik i ka refuzuar paditësit njohjen e shpenzimeve të karburantit për këtë periudhë, sipas vlerave respektive të konstatuara me

ekspertizë siç ka vepruar edhe pas kësaj periudhe me shpenzimet e transportit të llogaritura në Deklarata Unike Doganore. Arsyetimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar se shpenzimet e transportit për periudhën 01/2014-05/2016 janë përfshirë në DUD me rastin e importit dhe e njëjta është inkorporuar në koston e mallit të shitur, për Gjykatën nuk ka bazë të qëndrueshme, sepse në asnjë dispozitë ligjore të aplikueshme nuk është sanksionuar se nuk do të njihen blerjet-shpenzimet e përdorur për qëllime të transportit të mallit, nëse në DUD janë përfshirë shpenzimet e transportit sikurse pretendon e paditura. Gjykata thekson se siç ka konstatuar edhe e paditura me vendimin e kontestuar paditësi kryesisht aktivitetin e tij ekonomik e realizon përmes shitjeve transit të mallit për subjektet tjera, të cilin aktivitet e realizon me anë të mjeteve transportuese kamionëve të cilët i ka në dispozicion, andaj edhe nuk mund imagjinohet realizimi i aktivitetit ekonomik pa furnizim të karburantit. Në këtë drejtim Gjykata konsideron se për kundër asaj që paditësi furnizimin me karburant të automjeteve transportuese kamionëve e ka bërë në Kosovë përmes blerjeve vendore duke i regjistruar ato në librat dhe regjistrimet e biznesit dhe duke i paguar faturat e blerjeve tek furnitorët e mallit dhe më pastaj paditësi me kamion të tij ka bërë importin e mallit nga vendi eksportues dhe dërgimin e tij deri tek blerësit final në Kosovë, ky veprim nuk ja ndalon atij të drejtën që për qëllime tatimore ti njihen si të zbritshme (TVSH-ja e zbritshme dhe KMSH-ja) për blerjet e karburantit në tregun e brendshëm si dhe shpenzimet e transportit të llogaritura në Deklaratat Unike Doganore.

Dhoma e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, i pranon në tërësi si të drejta dhe ligjore konkludimet juridike të gjykatës së shkallës së parë, sa i përket gjendjes faktike të çështjes, e gjithashtu aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i vlerëson sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 49 të LKA dhe 194 të LPK. Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të kontestuar si në vështrim të nenit 41 të LKA, në drejtim të thënieve në padi, përgjigjes në padi, ekspertizës financiare si dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesorë dhe ka vlerësuar drejtë, se kërkesë padia e paditësit është plotësisht e bazuar dhe e drejtë dhe se e paditura nuk ka vepruar drejtë dhe sipas ligjit kur paditësit nuk i ka pranuar shpenzimet e karburanteve se shpenzimet e transportit janë inkorporuar në DUD për arsye se Dogana e Kosovës shpenzimet e

transportit dhe të sigurimit të mallit të importuar, gjegjësisht transportit rrugor të mallit i ka përcaktuar bazuar në UA nr.06/2015 për Përcaktimin e Kostos së Shpenzimeve të Transportit të Mallrave të Importuar. Gjykata konstaton se Dogana e Kosovës, paditësit në këtë rast i ka njohur shpenzimet e transportit bazuar në kilometrat e kaluara nga vendi eksportues i mallit e deri në terminal doganor bazuar në një çmim për kilometër i cili është 1.2€/km. Kësaj vlere i shtohet shuma fillestare e shpenzimeve në të cilën përfshihen: shpenzimet e përgatitjes së dokumentacionit përcjellës të mallit, ngarkimi, shkarkimi, taksat rrugore, vonesat, taksat e terminaleve, mëditjet e vozitësit dhe të ngjashme dhe se një gjë e tillë përcaktohet në nenin 4 të këtij UA. Gjykata thekson se në këto shpenzime kalkulohe vetëm shpenzimet e transportit nga vendi eksportues por jo edhe shpenzimet të cilat kanë ndodhur si në rastin konkret kur paditësi ka shkuar me kamionët e tij për ta marr mallin nga Kosova deri në Serbi dhe më pastaj mallin e ka sjellë në Kosovë deri tek blerësit e tij, përmes shitjeve transit, andaj gjykata konsideron se në këtë situatë nuk bëhet fjalë për shpenzime të dyfishuara të transportit, sepse në këtë rast siç ka deklaruar edhe eksperti financiar në seancën gjyqësore edhe shpenzimet e brendshme edhe ato ndërkombëtare kanë qenë të lidhura me mallin i cili është importuar dhe është sjell deri në pikën doganore, ndërsa shpenzimet e brendshme përfshijnë edhe transportin e mallit nga pika doganore deri te klienti – konsumatori i paditësit dhe se nga verifikimi i DUD-ave me të cilët është zhdoganuar malli i paditësit nuk gjenden fatura të karburantit të bashkangjitura.

Pretendimet ankimore të paditurës nga bazat ankimore të theksuara si më lartë si dhe pretendimet e tjera në ankesë, kolegji i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i vlerëson se nuk janë të qëndrueshme, sepse nuk janë të bazuara në prova dhe fakte të dëshmuara andaj kolegji gjen se aktgjykimi i ankimuar, nuk është i përfshirë me shkelje procedurale dhe ligjore siç pretendohet, sepse e njëjta ka shqyrtuar padinë, përgjigjen në padi pastaj ka caktuar seancë të shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme e që kuptohet se gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së. Gjykata e shkallës së parë për të vërtetuar rrethanat nëse paditësi ka mbajtur librat dhe regjistrimet e biznesit sipas legjislacionit tatimor dhe standardeve të kontabilitetit, pastaj nëse faturat e blerjes të paditësit të paraqitur kontrollit i plotësojnë kushtet ligjore për tu njohur për qëllime tatimore për TVSH të zbritshme dhe për KMSH për Tatim në të Ardhura Personale, saktësinë e

deklarimeve, librave dhe regjistrimeve të paditësit si dhe për të vërtetuar nëse shpenzimet e derivateve të paraqitura nga paditësi kanë ndodhur dhe nëse këto shpenzime janë argumentuar me dokumentacion përkatës në procedurë të kontrollit tek e paditura, me propozim të autorizuarit të paditësit në seancën e datës 15.10.2020 ka caktuar ekspertizë financiare në këtë konflikt administrativ. Nga vlerësimet dhe konstatimet e nxjerra të ekspertit financiar të datës 23.12.2020, plotësimin e saj të datës 23.12.2020 dhe të paraqitura edhe në seancën gjyqësore të datës 08.03.2021 nga ana e ekspertit Bali Morina, për vëllimin dhe lëndën e ekspertizës është dhënë konstatimi dhe mendimi profesional sipas të cilit paditësi evidencat kontabël të biznesit kanë qenë pjesërisht të sakta pasi që tatimpaguesi sa i përket pagesës së pranuar nga subjekti “Eko Farm” Sh.p.k nuk ka sjellë dëshmi bindëse. Eksperti ka dhënë konstatim se të gjitha faturat blerëse të tatimpaguesit janë të regjistruar në librin e blerjes dhe i plotësojnë kushtet ligjore për tu njohur për qëllime tatimore për TVSH dhe TAP, sipas ekspertit shpenzimet e derivateve të naftës si blerje vendore janë të lidhura me importimin e mallit por që në DUD nuk kanë mundur të hyjnë sepse është dashur që fatura të jetë jashtë territorit të Kosovës. Mjetet janë shpenzuar në vend, për qëllim importi dhe distribuim të mallit deri te konsumatori. Tutje eksperti ka shtuar se janë pranuar nga kontrolli shpenzimet e vlerësimit të DUD nga viti 2014 deri me 02.06.2016 ndërsa nuk janë pranuar faturat e blerjeve vendore, të cilat i janë paguar shitësit me kohë. Nga 02.06.2016 deri 31.12.2017 janë pranuar shpenzimet me fatura të blerjeve vendore të karburanteve dhe nuk janë njohur shpenzimet e vlerësimit në DUD. Këto shpenzime të derivateve kanë ndodhur dhe kanë elementet të argumentuara në bazë të dokumentacionit. Eksperti po ashtu ka konstatuar se për obligimet tatimore në shumë prej 34,975.76€ sipas Raportit të ATK-së të datës 21.12.2018, paditësi ka nënshkruar me datë 28.02.2020 me ATK-në marrëveshje për pagesën e tatimeve ku si rezultat i kësaj marrëveshje tatimpaguesi ka paguar detyrime tatimore të paditurës shumë prej 37,792.43€. Gjithashtu ka konstatuar se shpenzimet e derivateve të naftës në vlerë financiare si blerje vendore nga tatimpaguesi e që nuk është njohur për TVSH të zbritshme as kosto, sipas viteve të ekzaminuar në plotësim janë: për vitin 2014 blerje vendore prej 24,384.19€, TVSH e zbritshme vlera 3,901.50€, për vitin 2015 blerje vendore 18,862.56€, TVSH e zbritshme vlera 3,091.07€, viti 2016 blerje vendore vlera prej 7,277.13€, TVSH-ja e zbritshme prej 1,310.03€, ku gjithsej vlera prej 8,302.60€ është TVSH e zbritshme. Po ashtu sipas ekspertizës financiare tatimpaguesi për TAP për vitin 2016 dhe 2017 duhet të lirohet nga tatimi shtesë në vlerë të

përgjithshme prej 11,037.79€ ku tatimi shtesë për periudhën e kontrollit për këtë tatim duhet të mbetet në vlerë prej 2,680.96€ pas korrigjimeve nga vlera prej 13,718.75€ sikurse edhe Kontributet Pensionale CI nga vlera prej 5,425.10€ në vlerë prej 2,902.40€.

Gjendja faktike në këtë konflikt administrativ është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për çka nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit, për arsye se, gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjyimit të ankimuar. Sipas kolegjit të kësaj gjykate gjendja faktike në këtë procedurë është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë. Në këtë kuptim vlerësimet që ka dhënë gjykata e shkallës së parë për vlerën provuese dhe besueshmërinë e ekspertizës financiare, si prova të administruara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, i pranon si të tilla edhe ky kolegji, për të cilën ky është përfundim i drejtë dhe i pranueshëm.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadsisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

Kom.Dh.Sh.II.nr.1043/2022 me datë 04.09.2023

Kryetare e Kolegjit,
Franciska Zhitia Ymeri